

Për analizën e spermës

1. Mos kryeni marrëdhënie seksuale për një periudhë jo më të vogël se 3 ditë e jo më të gjatë se 5 ditë.
2. Marrja duhet bërë pas pastrimit të kujdesshëm të pjesëve të jashtme të organeve gjenitale dhe të duarve për të shmangur ndotjen e kampionit nga ana e florës bakteriale normale.
3. Kampioni duhet marrë nëpërmjet masturbimit dhe **jo** nëpërmjet marrëdhënies seksuale me ndërprerje (*coitus interruptus*) ose me anë të prezervativit.
4. Këshillojmë ta mbledhni të gjithë lëngun e spermës në një **enë të posaçme sterile me grykë të gjerë**, që mund të blihet në farmaci ose të merret në laborator.
5. Në rast marrjeje në shtëpi, kampioni duhet ruajtur në temperaturën 37° C dhe duhet dorëzuar në laborator brenda 30-60 minutave.

Për analizën e kulturës

1. Nuk është e nevojshme të respektoni ditët e abstenimit, por është e domosdoshme të keni ndërprerë çdo terapi kemioantibiotike të paktën që prej një jave
2. Marrja duhet bërë pas pastrimit të kujdesshëm të pjesëve të jashtme të organeve gjenitale dhe të duarve për të evituar ndotjen e kampionit nga ana e florës bakteriale normale
3. Kampioni duhet marrë nëpërmjet masturbimit dhe **jo** nëpërmjet marrëdhënies seksuale me ndërprerje (*coitus interruptus*) ose marrjes nëpërmjet prezervativit. I gjithë lëngu i spermës duhet mbledhur në një **enë të posaçme sterile me grykë të gjerë**, që mund të blihet në farmaci ose të merret në laborator.
4. Dorëzimi duhet bërë brenda një ore nga nxjerrja

Plotësoni këtë formular me të dhënat e kërkuara.

TË DHËNAT E PACIENTIT:

EMRI E MBIEMRI

DATËLINDJA

DITËT E ABSTENIMIT SEKSUAL.....

DATA e ORA e MARRJES

MARRJA NË SELI.....PO.....JO

Gjatë marrjes a pati humbje të materialit? JO

Po pjesa e parë
pjesa e dytë

Firma e pacientit